

VENDIM
Nr.973, datë 30.9.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS PICAR TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Picar të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Picar të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.901, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Picar të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Picar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Picar

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
5-9	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
10,20-25,27,28,30,34-38	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
11-19,26,29,31-33,39	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
40-50,55-58,60-67,69-70,72-79	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
81-85	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
86-87	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
88-92	Varrezat publike	Në pronësi
263-271	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të	Në përdorim

	ushqimit (toka produktive).	
272- 276,281,282,285,286, 294,295,299 (vetëm kanalet e III)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
302-406	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
408-409	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës- kanalizimeve.	Në pronësi